STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për njoftim të menjëhershëm: 11 prill 2013

GUVERNATORI CUOMO NJOFTON ZGJATJEN E AFATIT TË STREHIMIT PËR VIKTIMAT E SANDY

Programi i Ndihmës për Strehimin e Përkohshëm në Nju Jork zgjatet edhe për 17 ditë të tjera

Guvernatori Andrew M. Cuomo njoftoi sot se Agjencia Federale për Menaxhimin e Emergjencave (Federal Emergency Management Agency) (FEMA), me kërkesë të shtetit të Nju Jorkut, ka aprovuar zgjatjen për 17 ditë të programit të Ndihmës për Strehim të Përkohshëm (Transitional Sheltering Assistance) (TSA), që u jep mundësi të mbijetuarve të super stuhisë Sandy që kualifikohen dhe që nuk kanë mundësi të kthehen në shtëpitë e tyre, të qëndrojnë në hotelet dhe motelet pjesëmarrës të programit.

Data e re për largimin prej tyre e pjesëmarrësve në programin TSA është **1 maji 2013**. FEMA do t'u telefonojë aplikantëve të kualifikuar për zgjatjen, për t'i njoftuar për datën e re të largimit.

"Pothuaj pas gjashtë muaj nga koha kur super stuhia Sandy përmbysi gjithçka për banorët e kapur në rrugën e saj shkatërrimtare, programi i Ndihmës për Strehim të Përkohshëm vazhdon të jetë një burim jetësor për njujorkezët të cilët ende kanë nevojë për ndihmë strehimi", tha Guvernatori Cuomo. "Kjo zgjatje do t'u sigurojë atyre një vend të përkohshëm për të qëndruar ndërkohë që bëjnë përpjekje për tu kthyer në jetën normale".

Ky është një program afatshkurtër që i vendos familjet në hotele ndërkohë që ato punojnë për një plan strehimi afatgjatë.

Për t'u kualifikuar për TSA, të mbijetuarit duhet së pari të aplikojnë për asistencë federale nëpërmjet FEMA duke u:

- Regjistruar online në **www.DisasterAssistance.gov**;
- Regjistruar nëpërmjet smartfonit ose tabletës duke përdorur aplikimin e FEMA (app) ose duke hyrë në **m.fema.gov**; ose
- Regjistruar nëpërmjet telefonit në numrin **800-621-FEMA** (3362) (TTY 800-462-7585). Për shërbimin 711 ose Shërbimin Rele në Video (Video Relay Service) (VRS), merrni në telefon 800-621-3362.

###

Lajme të tjera do t'i gjeni në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418

Albanian